



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC**

---

Numri i lëndës: 2022:220984

Datë: 16.07.2024

Numri i dokumentit: 05943819

PPP.nr.105/2018

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditores EK, kundër debitorit B.M.D nga fshati Celinë, Komuna e Rahovecit, për përmbarimin e dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat e kontabilitetit, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 90.00 euro, në emër të shërbimeve publike heqjen e mbeturinave, lejuar me urdhrin për përmbarim, P.nr.458/17 të datës 01.12.2017, të përmbaruesit privat Gj.R nga Gjakova, duke vendosur sipas detyrës zyrtare, jashtë seancës gjyqësore, më datën 16.07.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. **KONSIDEROHET** i tërhequr propozimi për përmbarim i kreditores së përmbarimit EK, i paraqitur kundër debitorit të përmbarimit B.M.D nga fshati Celinë, Komuna e Rahovecit, për përmbarimin e dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat e kontabilitetit, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 90.00 euro, në emër të shërbimeve publike heqjen e mbeturinave, ashtu që përfundon procedura në këtë çështje përmbarimore.
- II. **HIQET NGA FUQIA** urdhri përmbarimor P.nr.458/17 të datës 01.12.2017, i lejuar nga përmbaruesi privat Gj.R nga Gjakova, si dhe të gjitha veprimet përmbarimore të ndërmarra në këtë procedurë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

## A r s y e t i m

Kreditorja së përbarimit EK, ka paraqitur për përbarimin e dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat e kontabilitetit, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 90.00 euro, në emër të shërbimeve publike heqjen e mbeturinave, përbaruesi privat Gj.R nga Gjakova duke vepruar sipas propozimit të kreditorit për përbarim ka lëshuar urdhër P.nr.458/17 të datës 01.12.2017, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat e kontabilitetit, i cili parashihet si dokument i besueshëm në nenin 29, paragrafi 1, pika 1.2 të LPP-së.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se në propozimin për përbarim nuk përmbante të gjitha të dhënat që kërkohen me nenin 38 par.1 të LPP-së në të cilin përcaktohet se *“Propozimi për përbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përbarimi, kërkuesi i përbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përbarimi, objekti i përbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përbarimit”*

Gjykata me konkluzion PPP.nr.105/2018 i datës 26.04.2023, ka kërkuar nga kreditori që në afat prej tre (3) ditëve ti siguroj adresën e saktë të debitorit, duke e njoftuar për pasojat ligjore se në të kundërtën nëse kreditori nuk e përmirëson propozimin do të konsiderohet se e ka tërhequr, nëse e kthen të pa përmirësuar, do të hedhet poshtë.

Në shkresat e lëndës ekziston prova – fletëkthesa, se përfaqësuesi i autorizuar i paditësit e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, me datën 02.05.2023, dhe nuk ka vepruar brenda afatit të caktuar nga Gjykata.

Meqenëse në nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (në tekstin e mëtejshëm LPP) është përcaktuar se: *“Në procedurën përbarimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër”*, atëherë në këtë rast gjejnë zbatim dispozitat nga neni 102 i paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore ku është paraparë se: *“Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësia po qe se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë”*,

Lidhur me shpenzimet procedurale u vendos duke u mbështetur në nenin 13 të LPP-së.

Nga të lartcekurat, e në bazë të nenit 17 të LPP-së, lidhur me nenin 38 , par. 1 dhe 102, par.1 dhe 3 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendim.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
PPP.nr.105/2018, më datën 16.07.2024.

Gjyqtari  
Avni Berisha

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate, për gjykatën e Apelit në Prishtinë, Divizioni Civil.